



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 21600Prot

Tiranë, më 21.9.2018

Lënda: **Njoftim për punësim me kontratë të përkohshme**

Drejtuar: **Të gjithë Degëve Doganore**

Për publikim: **Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 60 datë 31.01.2018 “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes vendore”, shpall njoftimin për punësimin me kontratë të përkohshme (6 orë/ditë) në pozicionin

- **Punonjës Shërbimi** në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. *Kategoria D2, 40 vende*

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë pushuar ndonjëherë më parë nga puna për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Të kenë arsim të lartë diplomë e nivelit Bachelor
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit;
8. Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj;

Përshkrim përgjithsues për pozicionin:

Punonjësit me kontratë të përkohshme do të kryejnë kontrolle në terren për pajisjen me pulla fiskale të vendosura në produktet e akcizës apo në kryerjen e detyrave sipas nevojave operative të DPD apo në kryerjen e detyrave për dhënien e informacionit lidhur me shërbimet e ofruara për subjektet dhe qytetarët nga autoritetet doganore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diplomë e nivelit Bachelor e noterizuar;
4. Kartë identiteti;
5. Fotokopje të kurseve kualifikuese;

Nuk pranohen kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale. Rezultatet do të bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 28.09.2018, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda Ikonomi**

